

V E N D I M
Nr. 87, datë 13.2.2003

**PËR IDENTIFIKIMIN DHE DETYRIMET E PERSONAVE, QË MARRIN SHËRBIM
SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat, të siguruar ose jo, që kërkojnë të marrin shërbim shëndetësor në institucionet shëndetësore të shërbimit parësor, në shërbimin shëndetësor dytësor, tretësor dhe në farmacitë e rrjetit të hapur, janë të detyruar të paraqesin, sipas rastit, dokumentacionin si më poshtë vijon:

- librezën e shëndetit;
- rekomandimin e mjekut të familjes;
- rekomandimin e mjekut specialist;
- mandatpagesën për vizitën ambulatorë pa rekomandim;
- mandatpagesën për vizitën te mjeku pa qenë i siguruar.

2. Të siguruar quhen personat që paguajnë kontributin e sigurimeve shëndetësore, si dhe personat për të cilët shteti paguan kontribute, sipas nenit 8 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Të gjithë personat, që nuk janë të siguruar sipas pikës 2 të këtij vendimi ose kur janë të siguruar, por nuk paraqesin dokumentacionin sipas pikës 1, marrin shërbim shëndetësor duke paguar tarifat e miratuara në sistemin shëndetësor ose çmimin e plotë të barnave.

4. Institucionet shëndetësore janë të detyruara të pranojnë sipas pikës 1, kontrollin e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë, që, në mbështetje të propozimit të Këshillit Administrativ të Institutit të Shërbimit Shëndetësor, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano